

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 47, 20 – 26 Nëntor 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 47

	JAVA 47
DIARRE PA GJAK	1.303
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.542
INF. RESP. TE POSHTËME	3.346
RASH ME TEMPERATURË	18
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	399
% e Njësive Raportuese	93% (399/427)

Rash me temperaturë

16 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit, 1 rast nga rrethi i Vlorës dhe 1 rast nga rrethi i Tiranës. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit 14 nga rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Në rrethin e Fierit 4 prej rasteve janë të suspektuar për sëmundjen dorë-këmbë-gojë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në Kosovë, Maqedoni, Greqi si dhe shtete të tjera te Europës dhe Ballkanit, theksojmë përforcimin e Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” dhe raportimin e këtij sindromi nga të gjithë mjekët. Po ashtu ritheksojmë se çdo rast me rash makulopapular dhe temperaturë duhet të vlerësohet në kuadër të Fruthit dhe Rubeolës.


Tërhiqet vëmendje për survejancën aktive të “rash me temperaturë” në komunitetin rom si edhe në institucionet parashkollore dhe në shkolla si dhe identifikimi dhe vaksinimi i të pavaksinuarve në të gjithë rrethet.

Vlerësimi Shëndetësor në zonat e përmbytura


Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Shërbimin Shëndetësor dhe Shtabin e Emergjencave në qarqe po kryen monitorimin e sëmundshmërisë në zonat e përmbytura dhe të riskuara në të gjithë vendin për përgjigjen e shpejtë dhe parandalimin e shpërthimeve epidemike.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet i qëndrueshëm në javën e 47 krahasuar me javën paraardhëse, java e 46.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqitet i qëndrueshëm në javën e 47 krahasuar me javën paraardhëse, java e 46.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 35 - 47 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.




Në javën e 47 të vitit 2017 vërehet një trend i qëndrueshëm i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 3% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Diarre pa Gjak” sipas grupmoshës në javën 47 të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 46 dhe 47 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)




Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 35 - 47 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.



Në javën e 47 të vitit 2017 vërehet një trend i qëndrueshëm i numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 1% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 46 dhe javën 47 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me rrethet, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 47 sipas rretheve, në përqindje.

